

Tiranë më 27.07.2023

Nga: Euro Balkans News SH.P.K

Drejtuar: Regjistri Global i Medias
Në vëmendje të Znj. Nafisa Hasanova

BIRN Albania
Në vëmendje të Znj. Kristina Voko

Lënda: Kthim përgjigje

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për ftesën për kërkesë për transparencë proaktive përsa në fushën e medias në Shqipëri si dhe për konsideratën ndaj Euronews Albania si një ndër 40 mediat kryesore informative në Shqipëri, në vijim të kësaj shkrese dëshirojmë të ndajmë informacionin e kërkuar.


Shoqëria Euro Balkans News SH.P.K është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2018, me objekt të aktivitetit: “veprimtari në fushën e mediave audiovizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim të programeve dhe informacioneve të ndryshme audiovizive”, e pajisur me licencë Nr. 192/2019 “Për Shërbimin e Programit Audioviziv”, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me emër subjekti OSHMA “Euronews Albania”.

Euronews Albania është franchizing direkt i “Euro News” S.A në Lyon Francë dhe zbaton me përpikmëri politikën e tij editoriale të pavarura, Kartën Editoriale të Euronews, Kodin e Etikës dhe Kodin e Sjelljes, si dhe ushtron veprimtarinë e saj në respektim të plotë të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Në kuadër të kërkesës tuaj, si vijon do të gjeni informacionin e detajuar në lidhje me shoqërinë Euro Balkans News SH.P.K.


i. Informacioni mbi aksionarët e dhe përqindjet që ata kontrollojnë.

Shoqëria Euro Balkans News SH.P.K është themeluar dhe zotërohet 100% nga shoqëria Inter Media Group SH.P.K. Në vijim po ju parashtrijmë një skemë në lidhje me strukturën e pronësisë:



ii. Informacion në lidhje me aksionet e kompanisë suaj në media të ndryshme si dhe kompani në sektorë të tjerë.

Shoqëria Inter Media Group SH.P.K, si shoqëria mëmë zotëruese e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë Euro Balkans News SH.P.K, është një shoqëri me një portofol të diversifikuar, e cila zotëron kuota në shoqëritë e paraqitura në formë skematike si vijon:



Në vijim të formës skematike në të cilën qartësisht është paraqitur pjesëmarrja në përqindje kapitali e shoqërisë Inter Media Group SH.P.K, konsiderojmë të nevojshme të specifikojmë fushën e veprimtarisë së shoqërive përkatës, të cilat janë si më poshtë vijon:

- a. Shoqëria “Tok Media” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ushtron aktivitetin e saj me fokus në transmetime radio televizive, analoge dhe digjitale. Shoqëria është e pajisur me licencë audio analoge vendore, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me emër subjekti OSHMA “In Radio 105.7”.
- b. Shoqëria “Inter Active Media” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ushtron aktivitetin e saj me fokus në fushën e mediave audiovizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim të programeve dhe informacioneve të ndryshme audiovizive. Shoqëria është e pajisur me licencë “Për Shërbimin e Programit Audioviziv të Përgjithshëm”, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me emër subjekti OSHMA “IN TV”.
- c. Shoqëria “La Strada” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ushtron aktivitetin e saj me fokus në shërbime reklamimi *outdoor*.
- d. Shoqëria “City Wings” SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ushtron aktivitetin e saj me fokus në shërbime reklamimi *outdoor*.

iii. Një listë me persona që aktualisht mbajnë pozicione me ndikim në Euronews Albania, përfshirë emrat e bordit manaxhues, bordit këshillues, manaxhimit editorial dhe/ose enteve me ndikim mbi kompaninë dhe mediumet.

- a. Bordi Editorial i Euronews Albania, bazuar në Kontratën Franchizing si edhe politikat editoriale të Euronews S.A si edhe bazuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Inter Media Group SH.P.K No.1, date 21.01.2020 si edhe me ndryshimet e datës 17.02.2020, është i përbërë nga:

Kryetar: Znj. Françoise Champey (përfaqësuese e Euronews S.A)

Anëtar: Z. Peter Barbas (përfaqësues i Euronews S.A)

Anëtar: Z. Franko Egro (përfaqësues i Euronews Albania)

- b. Euronews Albania, në përputhje me parashikimet e Ligjit 9901/2008, respektivisht nenet 68-104, ka caktuar Administrator Znj. Jonida Gjoka me afat deri në datë 09.07.2028.

iii. Informacion mbi të ardhurat, fitimin operativ, burimi i të ardhurave dhe në veçanti, përqindja e financimeve të drejtpërdrejta apo indirekte nga qeveria gjatë vitit financiar 2022

- Të ardhurat 2022 rezultojnë në vlerën 216,141,281 ALL
- Fitimi operativ: shoqëria rezulton me humbje
- Burimi i të ardhurave: të ardhurat e shoqërisë kryesisht janë nga reklamat
- Financime nga qeveria: nuk ka pasur asnjë financim nga qeveria gjatë vitit 2022

iv. Informacion mbi shikueshmërinë e Euronews Albania dhe lexueshmërinë e Euronews.al gjatë tre muajve të fundit (Mars-Maj 2023)

Duke qënë se në R.Sh-së nuk ka as edhe një institucion apo kompani të liçensuar nga autoritet vendase që të realizojë matje të shikueshmërisë dhe/ose lexueshmërisë, më poshtë jeni të lutur të gjeni vlerat e shikueshmërisë në kanalën YouTube si edhe vlerat e lexueshmërisë në faqen zyrtare të Euronews.al:

KANALET DIGJITALE	MARS 2023	PRILL 2023	MAJ 2023
YOUTUBE	12,325,187*	13,036,507*	17,200,434*
WEBSITE	5,370,975**	6,807,646**	7,142,122**

*Të dhëna mbi shikueshmërinë e kanalit zyrtar të Youtube të Euronews Albania.

**Të dhëna mbi lexueshmërinë e faqes zyrtare të internetit Euronews.al.

|